

VENDIM
Nr.22, datë 19.6.1998

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fehmi Abdiu	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Hajredin Fuga	Anëtar i	'''
Zija Vuci	Anëtar i	'''
Franc Jakova	Anëtar i	'''
Kristofor Peçi	Anëtar i	'''
Kujtim Puto	Anëtar i	'''
Sokol Sadushi	Anëtar i	'''
Alfred Karamuço	Anëtar i	'''
Hilmi Dakli	Anëtar i	'''

me sekretare Drita Filto, më datë 25.5.1998 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.18 Akti, që i përket:

Kërkues: Sherif e Natasha Belishta

Subjekt i interesuar:1. Ndërmarrja komunale Banesa-Tiranë 2. Hane Hasani, i përfaqësuar nga avokati Petrit Klosi.

Objekti: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.4095, datë 2.8.1994 i gjyqtarit të vetëm të Gjykatës së Rrethit - Tiranë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi shqyrtoi çështjen në mungesë të kërkuesve dhe në prani të përfaqësuesit të palës së interesuar, avokatit Petrit Klosi me prokurë,

VËREN:

Mbi padinë e Hane Hasanit para Gjykatës së Rrethit - Tiranë, kundër Ndërmarrjes Komunale-Banesa Tiranë dhe Sherif Belishtës me objekt: "Deklarimin të pavlefshëm të kontratës së qirasë dhe privatizimit të një banese në bazë të neneve 17, faqe 6, 281 e 287 të ish-Kodit Civil atëherë në fuqi dhe ligjit nr.7672, datë 11.12.1993 "Për një shtesë në ligjin nr.7652, datë 23.12.1993, gjyqtari i vetëm, me vendimin nr.4095, datë 2.8.1994 ka vendosur pranimin e padisë me deklarinimin të pavlefshëm të kontratës së shitjes (privatizimit) të lidhur midis të paditurit Sherif Belishta dhe N.K. Banesa 1, Tiranë për apartamentin e ndodhur në rr. "Sh.Peza", pall.2, shk.2, ap.16 dhe njëkohësisht detyrimi i N.K.Banesa nr.1 të privatizojë këtë apartament në favor të paditëses Hane Hasani.

Vendimi ka marrë formë të prerë i paankimuar.

Kërkuesit Sherif e Natasha Belishta i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese me pretendimin se vendimi i Gjykatës së Rrethit i sipërpërmendur është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor që parashikon neni 38 i ligjit kushtetues nr.7692, datë 31.3.1993 "Për një shtojcë në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", kreu "Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut", për këto arsye:

1. është gjykuar nga një gjyqtar i vetëm në kundërshtim të hapur me nenin 62 të Kodit të Procedurës Civile të vitit 1982, kurse duhej gjykuar me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar dhe dy ndihmësgjyqtarë;

2. gjyqtari i vetëm ka konstatuar disa pavlefshmëri veprimesh pa i thirrur fare palët;

3. në gjykim nuk është thirrur e nuk ka marrë pjesë fare bashkëshortja Natasha Belishta, e cila është bashkëpronare në kontratën e privatizimit të banesës.

Gjykata Kushtetuese pa i hyrë fare zgjidhjes së çështjes në themel vëren:

1. Gjykimi i çështjes nga një gjyqtar i vetëm vjen në kundërshtim me ligjin nr.7337, datë 17.12.1991 "Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë", neni 7, faqe 2.

2. Mosthirrja e Natasha Belishtës që është bashkëpronare në shtëpinë objekt gjykimi pas privatizimit të banesës objekt i vendimit nr.4095, datë 2.8.1994 është mosformim i rregullt i ndërgjyqësisë. Të dyja këto shkaqe përbëjnë proces të parregullt ligjor që është një e drejtë kushtetuese

e parashikuar nga neni 38 i ligjit kushtetues “Për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut” me këtë përmbajtje: “Liria, prona ose të drejtat e pranuar me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor”.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pika 9 e ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” me shumicë votash,

VENDOSI:

Shfuqizimin e vendimit nr.4095, datë 2.8.1994 të Gjykatës së Rrethit, Tiranë dhe kthimin e çështjes asaj gjykatë për rishqyrtim.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.